



Nr. 230 Prot. Datë 30/06/2021

23860/1  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot. Datë 21/7/2021

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot, më datë 30/06/2021, në Tiranë, lidhet kjo marrëveshje që synon bashkëpunimin në vijim mes palëve:

1. **“Universiteti Metropolitan” Tirana** (këtu e në vazhdim “Universiteti Metropolitan” Tirana), i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 357, datë 12. 05. 2010 “Për Licencimin e Shkollës së Lartë Universitare Private “*Universiteti Metropolitan*” Tirana, përfaqësuar nga administratori z.Arjan Çukaj me dokument identifikimi Letërnjoftim ID me nr.028709198.

dhe

2. **Bashkia e Tiranës**, me adresë: “Sheshi Skënderbej”, nr. 2, kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, Kryetar, në vijim e cilësuar si **“Bashkia”**

### NENI 1

#### OBJEKTI

Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi midis palëve, në lidhje me zhvillimin e praktikave mësimore pranë Bashkisë Tiranë, për studentët e Universitetit Metropolitan të Tiranës.

Gjithashtu marrëveshja synon edhe bashkëpunimin në drejtim të shkëmbimit të eksperiencave dhe realizimin e projekteve të përbashkëta.

### NENI 2

#### BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje bazohet në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) dhe ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).

### NENI 3

#### KOHA E PRAKTIKËS

Koha e zhvillimit të praktikës mësimore realizohet gjatë periudhës së studimeve në përputhje me planet mësimore dhe programet akademike të "Universitetit Metropolitan" Tirana, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

### NENI 4

#### AMBIENTET

Praktikat mësimore do të zhvillohen në ambientet pranë zyrave të institucionit të Bashkisë Tiranë, sipas përcaktimeve të bëra përpara fillimit të praktikës.

"Universiteti Metropolitan" Tirana, përcakton ambientet për organizimin e shkëmbimit të eksperiencave të përbashkëta me **Bashkinë Tiranë**.

### NENI 5

#### ANGAZHIMET E PALËVE

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në frymën e një mirëkuptimi reciprok si dhe me vullnetin pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e angazhimit dhe iniciativat e ndërmarra nga njëra palë ose në bashkëpunim.

Universiteti Metropolitan- Tirana angazhohet të dërgojë listën me emrat e studentëve të cilët do të kryejnë praktikën pranë Bashkisë Tiranë.

Për periudhën e praktikës, studentët janë të detyruar t'i nënshtrohen rregullave dhe kërkesave të Bashkisë Tiranë.

Bashkia do të ofrojë kushtet e nevojshme për kryerjen e praktikës me qëllim përfitimin nga ana e studentëve të një kualifikimi sa më cilësor.

Çdo student në përfundim të praktikës do të marrë një formular vlerësimi ose vërtetim, nga Bashkia e Tiranës.

### NENI 6

#### KOMUNIKIMI

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve, në funksion të kësaj marrëveshjeje bëhen nëpërmjet personave të kontaktit si më poshtë vijon:



Për Bashkinë Tiranë:

znj. Natali Shkëmbi

Specialit ne DPBNJTZH

email: [natali.shkembali@tirana.al](mailto:natali.shkembali@tirana.al)

Për UMT:

znj. Marsela Salavaçi

Këshillim Karriere

[msalavaci@gmail.com](mailto:msalavaci@gmail.com)

## NENI 7

### DISPOZITA TË FUNDIT

- 7.1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë 1 (një) vjeçare.
- 7.2. Çdo rregullim ose ndryshim në këtë marrëveshje bëhet vetëm në formë të shkruar dhe nëpërmjet pëlqimit reciprok të Palëve.
- 7.3. Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) kopje për secilën palë, të cilët pasi bien dakord e nënshkruajnë atë rregullisht.
- 7.4. Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga Palët.

**“Universiteti Metropolitan” Tirana**

**Bashkia Tiranë**

**PRESIDENTI**

**ADMINISTRATORI**

Z. Arjan Çukaj



**KRYETARI**

Z. Erion Veliaj



